

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

“ **BARON INVEST** “ sh.p.k

Sot ,me date **14.06. 2024** (dymije e njëzete e kater) ne Tirane

Une themeluesi Z..Gjolek Mete Shehu , shtetas Shqiptar , lindur më Vasjar, Tepelene më 23.11.1953 , me nr ID card F31123048N ,me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“**BARON INVEST**” sh.p.k

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet “**BARON INVEST**” shpk . (Këtu e mëposhtë “Shoqëria”)
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

Neni 2

Selia

- 2.1. Selia e shoqërisë do të jetë ne Gjirokaster Tepelene **TEPELENE** Rruga Nacionale Tepelene - Vlore Sh. 76 Zona Kadastrale 3574, Numer pasurie 24/92-ND.



Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4

Objekti

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Ndertimi dhe ristrukturimi si për llogari të vetë shoqërisë ashtu dhe për llogari të të tjerëve, të ndertimeve, projekteve, zbatimeve në fushën e ndertimeve civile, turistike, bujqësore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, objekte kulturore, rrugë, infrastrukture, rikonstrukcione civile, mirëmbajtje, zhvillim dekorativ në mjedise urbane, etj.. Ndertimi dhe mirëmbajtja e çfarëdo impianti teknologjik. Ndertimi dhe mirëmbajtja e rrugëve. Punimi i gurëve, minierave dhe i torfes si në ambiente të mbyllura edhe të hapura. Shitblerja, shkëmbimi dhe marrja me qira e pasurive të çdo lloji, natyre dhe destinacioni si edhe e të drejtave lidhur me pasuritë e paluajtshme. Menaxhimi i qirave si për ndërtesat në pronësi ashtu edhe për ato prone të të tjerëve. Menaxhimi i aktiviteteve pritëse, turistike, hoteliere dhe jo hoteliere. Shitblerja e markave dhe patentave në sektoret si më sipër. Do të jete në gjendje të kryejë të gjitha operacionet financiare, të pasurive të patundshme, tregtare, industriale e financiare të nevojshme dhe të nevojshme për të arritur qëllimin e shoqërisë. Kompania gjithashtu, mund tefutet në interesa dhe pjesëmarrje financiare, edhe aksionare, në shoqëri ose aktivitete të tjera që kanë veprimtari të ngjashme ose të përafert me qëllimin e vetë shoqërisë;

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR


NENI 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (njëqind lekë) i përbërë nga 1 (një) kuota.

Kapitali i shoqërisë përbehet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë.

Z. Gjolek Mete Shehu zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë në vlerë 100 lekë (njëqind lekë).



Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjetër te shoqerise. Ortaku tjetër ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortakun duhet ta ushtroje Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakun qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerit e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortakun tjetër te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

NENI 8

Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe te drejtat qe janë krijuar para largimit te tij .

NENI 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarisë dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve ne proporcion me përqindjen e kapitalit te investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund te zvogëlohet nen kufijtë e parashikuar ne ligj .

NENI 11

Shoqëria tregtare "BARON INVEST" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurive se vet tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare "BARON INVEST" sh.p.k. gezon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.



NENI 12

Shoqëria tregtare "BARON INVEST" sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet qe ortaku kane pasur para se ajo te krijohet.

KAPITULLI I III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Kompetencat e ortakut

13.1 Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë se saj, duke përfshire edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko financiare ne çdo faze te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te përfaqësueseve ne këtë aktivitet.

13.2 Kane te drejte te tërheqin te gjitha dokumentet kryesore te shoqerise per tre vjetet e fundit

13.3 Kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin pjesen e kapitalit te tyre ne perputhje me kushtet qe i lejon statute dhe ligji.

13.4 Ortaket ne perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjisllacionin ne fuqi kane, te drejte qe ne te njejten kohe te jene ortake edhe ne shoqeri te tjera.

13.5 Ortaket rezervojne te gjitha te drejtat sipas ligjit Tregtar.

NENI 14

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj *z.Gjolek Shehu*.

NENI 15

Administrimi i shoqërisë

15.1 Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, me qellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakeve.

15.2 Administratori përfaqëson shoqërinë ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administratës dhe atyre gjygesore.



15.3. Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo per deme te kryera gjate administrimit. Ortaku ka te drejte te ngrej padi ndaj administratorit.

15.4 Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim te ortakut, kan të drejtë të veprojnë, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

15.5 Shoqeria administratohet te pakten 1(nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator , te cilet qendrojnë ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej (5 vjetesh

15.6. Çdo administrator do te ketë te drejte për rimbussimin e shpenzimeve te bera prej tij per llogari te shoqërisë .

15.7 Kur administrator i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin financiar te kompanise atehere ortaket vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij ne fund te vitit financiar .

NENI 16

Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe te drejta.

- Te mirë administroje pasurine e shoqerise
- Te lidhe marveshje me te tretet Brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket.
- Te zbatoje rregullat e brendeshme te shoqerise
- Te shperbleje demet qe I vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve te tij.
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marveshjes se bere midis tij dhe ortakeve.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quant e dobishme per shoqerine
- Te mirtaoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe ti paraqese ato sipas rastit per miratimin perfundimntar nga ortaket
- Te behen prpozimet perkatese ortakut te vetem kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne aportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin e personelin
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise dhe te krijojne organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektiveve te shoqerise.
- Ti propozoje ortakeve per krijimin e enjesive strukturave te ndryhsme si filial, dege e e përfaqësi ne qytetet te tjera te vendit ose jashte shtetit.
- Te përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë se shoqërisë dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqes propozimet për miratim para ortakeve .

- Te siguroje zbatimin e përpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- Te kryeje çdo detyre tjetër që i ngarkohet nga ortaku i vetem i shoqërisë.

NENI 17 EKSPERTI KONTABEL

17.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar. Caktimi i tyre e bënë administratori

17.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë

17.3 Ato përgjigjen për demet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

17.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi .

17.5 Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë në gjini e krushqi deri në shkallën e katert. Po ashtu nuk mund të kryeje këto detyra përgjegjësat e syrave, filialeve e agjensive.

KREU III MARDHENIET E PUNES NENI 18

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 19

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 20

Sekreti i punës

Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KAPITULLI I IV VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 21

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Përgjashtimisht Viti I parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të te një viti.



NENI 22

Inventari dhe llogarite vjetore.

Shoqëria do të mbaje një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore

Në mbylljen e vitit financiar administrator harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogarite vjetore për vitin financiar .

NENI 23

Raportet vjetore

23.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe kontabilisti harton inventarët dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.

23.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

23.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 24.

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.

24.1 Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit të mëparshëm, hiqet menjëherë një shumë e barabartë me 5 % (pese përqind) e fitimit të destinuar për formimin e fondit rezerve të quajtur "rezerve e domosdoshme".

24.2 Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon në qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrijë 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.

24.3 Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçante në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

NENI 25

Te ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuar siç është vendosur nga ortakët duke i qëndruar në uljen 5 % që do të destinohet rezervës ligjore.

KAPITULLI V MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI



NENI 26

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjate dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 27

27.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaket caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjate likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e siper".

27.2 Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakeve.

27.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 28

Ortaket vendosin mbi rregulshmerine e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortaket mund të vendosin vetë realizimin e kesaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 29

Kur ortaket për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqeriac' regjistrohet prej tij.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 30

Dispozitat e fundit


30.1 Për të gjitha ceshtjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

30.2 Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"

30.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të çenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 31

Gjykata kompetente.



Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit te Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 32

Hyrja ne fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

“ BARON INVEST “ sh.p.k.

GJOLEK SHEHU

